



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 80

Prishtinë, më 3 qershor 2013, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S -2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Behar Selimi, Mufera Shinik, Haki Demolli Ardian Gjini, Gëzim Kelmendi, Arsim Bajrami, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivković.

Mungoi: Halit Krasniqi

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Valdete Daka, Miradije Mavriqi dhe Enis Halimi – KQZ, Armend Shkoza – LVV, Petrit Hysaj- OSBE, Artan Canhasi- EULEX, Visar Smajlaj, ekspert, Fidan Rama , “Tribuna”, Shqipe Osmani, “Bota Sot”, Blerta Bejtullahu – Zyra e BE-së dhe studentët e Universitetit AAB.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi , kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.4.2013;
3. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2012;
4. Përfundimi i Kuvendit nr. 04-V-609;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari, propozoi që pika katërt të hiqet nga rendi ditës.

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.4.2013;

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur me 22.04.2013, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2012;

Kryetari, ftoi kryetaren e KQZ-së, znj. Valdete Daka, që ta paraqesë raportin.

Valdete Daka, pasi paraqiti raportin, foli edhe për memorandumin e bashkëpunimit me Asociacionin e Komisioneve Zgjedhore Evropiane (ACEEEO). Po ashtu, znj. Daka, e njoftoi Komisionin se grupi punues, që po merret me pastrimin e listave, ka arritur që deri më tani, përafërsisht, 30 mijë emra t'i heq nga lista e votuesve, e cila do t'ju përcillet edhe subjekteve politike, 60 ditë para zgjedhjeve, në mënyrë që edhe ata të japin kontributin e tyre, në pastrimin e listës. Në vazhdim, si sfidë, ajo përmendi nevojën e rishikimit të legjislacionit, Ligjit nr. 03/L196 dhe Ligjit Nr. 03/L-174, për financimin e subjekteve politike dhe kërkoi që KQZ-ja, mos të ketë kompetencë në shpërndarjen e financave për subjektet politike.

Kryetari, duke folur rreth raportit, tha se pa dyshim që lista votuese mbetet shqetësim sepse në disa zona, lista e votuesve po është e barabartë me numrin e banorëve. Ai pyeti se a ka pas ndonjë auditim të listës së votuesve dhe çfarë probleme janë evidentuar nga ky auditim ? A është e mundur teknikisht, që të ndahet lista e votuesve, që janë qytetarë jo rezident në Kosovë dhe lista e votuesve ?

Duke folur për pastrimin e listave, ai pyeti se për sa kohë janë heq nga lista ata 30 mijë emra dhe sa për qind e listës është analizuar ?

Duke folur për digjitalizimin e procesit zgjedhor, kryetari pyeti se a mund të aplikohet diçka e tillë në Kosovë ?

Haki Demolli, duke folur rreth raportit, demantoi atë se çfarë thuhet në raportin e KQZ-së, si mungesë të bashkëpunimit, duke shtuar se kryetares së KQZ-së, i është dhënë edhe kryesimi i një grupi punues, në kuadër të reformës zgjedhore dhe kjo sfidë nuk qëndron, sepse të gjitha vërejtjet, sugjerimet dhe rekomandimet, që i ka dhënë KQZ-ja si Komision për reformë zgjedhore i kemi marr në konsideratë dhe kanë qenë objekt trajtimi.

Duke folur për pastrimin e listës së votuesve, Demolli pyeti se sa jeni të kënaqur me këtë proces dhe a mendoni që deri në zgjedhjet e radhës do të do të ketë përmirësime të listës.

Arsim Bajrami, pyeti sa a është duke bërë përgatitje shtesë, si KQZ për mbajtjen e zgjedhjeve në katër (4) komunat, pasi që marrëveshja për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë ju ka proceduar Kuvendit për ratifikim ?

Albulena Haxhiu, tha se marrëveshja që është arritur në Bruksel, është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, sepse në piken 11, i jep kompetencë OSBE-së, të organizojë zgjedhje dhe është shkelje e nenit 139, të Kushtetutës, që i jep autoritet KQZ-së, si të vetmit autoritet të organizojë zgjedhje. Edhe mospastrimi i listave, vazhdon të mbetet shqetësim për ne si subjekt politik dhe shoqërinë civile, sepse kjo mënyrë e pastrimit të listës do të rrezikojë, që në zgjedhjet e ardhshme të jenë mbi 35 mijë njerëz më shumë, të cilët ose kanë vdekur ose nuk janë më shtetas të republikës së Kosovës. Bazuar në planin e punës së KQZ-së, shihet që mbi 50 % e tij ka dështuar të zbatohet.

Shqetësuese mbeten punësimet mbi baza familjare dhe partiake dhe mori shembull rastin e zyrtarit komunal zgjedhor në Ferizaj, gruaja e të cilit është zyrtare komunale në Shtime. Po ashtu rasti i punësimit të zyrtarit zgjedhor, në pozitën e babait, pasi që ai kishe dal në pension. Po ashtu shqetësuese është edhe fakti se në fund të viti, keni shpërnda mbi 40 mijë euro, në emër të punës shtesë për anëtarët e KQZ-së dhe stafin tuaj, në mënyrë të kundërligjshme.

Ajo ishte e mendimit, që edhe plani i punës për vitin 2012, duhet ti bashkëngjitet raportit, sepse Kuvendi duhet ta ketë këtë plan. Haxhiu foli edhe për transparencën, sepse siç tha kjo flitet që shoqëria civile është e përjashtuar.

Ardian Gjini, duke folur për listën e votuesve dhe mënyrën e pastrimit të saj, tha se nuk munden dhe nuk kanë kompetencë, që subjektet politike për 60 ditë t'i verifikojnë listat e votuesve, sepse ky është obligim i KQZ-së, ngase, ju e përgatisni stafin me vite, i trajtoni dhe shpenzoni mjete për këtë punë dhe mos pritni prej partive politike të verifikojnë listën. Ajo që duhet të insistoj KQZ-ja, është që lista e votuesve të shihet drejtpërdrejt (online), në mënyrë që secili qytetarë të ketë të drejt ta shoh.

Armend Zemaj, duke folur për raportin, tha se pothuajse është i njëjtë me atë të vitit të kaluar, me ide të njëjta dhe rekomandime të njëjta. Përmirësimi i gjendjes, rreth organizimit zgjedhor është në degradim e sipër. Ai tha se edhe vitin e kaluar KQZ-ja nuk ka mundur t'i arsyetojë se si janë shtuar 40 mijë votues, gjatë zgjedhjeve të vitit 2010, kurse tani edhe pas regjistrimit të popullsisë në Ferizaj, është numri i njëjtë i votuesve dhe i banorëve, të cilët kanë të drejtë vote. Po ashtu, bashkëpunimi me MPB-në, nuk është në nivel të duhur dhe nuk është serioz. Zemaj e vlerësoi zgjedhjen e kryeshefit, por paraqiti shqetësimin e tij se as vitin e kaluar nuk është sqaruar mënyra e dorëheqjes së ish- kryeshefit ekzekutiv dhe zgjedhja e këtij të fundit.

Ai pyeti se a do të ndryshojë numri i qendrave të vendvotimeve, a ka propozime të reja nga komunat, sepse duhet të jemi të njoftuar me planin se si jeni duke zhvilluar sepse në momentet e fundit, qytetarët kanë vështirësi me qendrat e vendvotimeve?

Gëzim Kelmendi, ngriti si shqetësim, financimin e subjekteve politike sepse siç tha ky, nuk ka një transparencë të financimit. Po ashtu, ai tha se shumë subjekte janë inkriminuar në keqpërdorimin e votës së qytetarëve dhe pyeti se a ka KQZ-ja ndonjë strategji për përmirësimin e gjendjes, sepse avancimi i teknologjisë po jep mundësi për keqpërdorime?

Ardian Gjini dhe Mufera Shinik e lëshuanë mbledhjen në orën 13:00.

Pyetjeve të anëtarëve të Komisionit ju përgjigj znj. Valdete Dake, ndërsa pas përfundimit të prezantimit të raportit dhe përgjigjeve që iu dhanë anëtarëve të Komisioni, kryetari konstatoi se në momentin e votimit, të pranishëm ishin 7 deputetë.

Kryetari Konstatoi se Komisioni, me 3 vota “për” dhe 4 vota “kundër”, nuk e miratoi Raportin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2012, dhe e vlerësoi të nevojshëm që pjesë e raportit të jetë edhe plani i punës, para se Raporti i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2012, t’i procedohet seancës për shqyrtim dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të mos miratohet Raporti i Punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2012.

Mbledhja përfundoi në orën 13:35.

E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi